



# ZËRI I VOTUESVE

Problemet që Votuesit Kërkojnë të Adresohen nga Qeveria



24 orë ujë & rymë

Asfaltoni rrugët tona!

Bëni politika që ofrojnë punë!

Ndal korrupsionin & nepotizmin

Instaloni ujësjellës funksional!

Siguroni shërbime cilësore shëndetësore

Ndaloni ndotjen e ambientit!

Shtator 2008 - Mars 2009  
Reporti #1

# ZËRI I VOTUESVE

Problemet që Votuesit Kërkojnë të Adresohen nga Qeveria

**Raporti #1: Shtator 2008 – Mars 2009**

Prishtinë, Kosovë 2009

Publikuar nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2009.

© 2009 Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8, Prishtinë, 10000 Kosovë.

Kopjimi dhe ribotimi është i mundshëm dhe inkurajohet, por ju lutem njoftojeni burimin.

Projekti Zëri i Votuesve është bërë i mundshëm me ndihmën e Ambasadës Britaneze në Kosovë dhe nga Posta dhe Telekomu i Kosovës (PTK). Këndvështrimet e paraqitura në këtë raport jo domosdoshmërisht përkojnë me ato të Ambasadës Britaneze apo PTK-së.

# PËRMBAJTJA

**Hyrje** **1**

**Metodologjia** **2**

**Ankesat e kujt janë në këtë raport?** **3**

**Top dhjetëshi i shqetësimeve të qytetarëve** **5**

**Zëri i Votuesve në komuna** **7**

Komuna e Aratnës	07	Komuna e Malishevës	25
Komuna e Dardanës	08	Komuna e Mitrovicës	25
Komuna e Deçanit	09	Komuna e Pejës	27
Komuna e Dragashit	10	Komuna e Podujevës	28
Komuna e Drenasit	11	Komuna e Prishtinës	29
Komuna e Ferizajit	13	Komuna e Prizrenit	31
Komuna e Fushë Kosovës	14	Komuna e Rahovecit	32
Komuna e Gjakovës	15	Komuna e Shtërpcës	33
Komuna e Gjilanit	17	Komuna e Shtimes	33
Komuna e Hanit të Elezit	18	Komuna e Skenderajt	34
Komuna e Istogut	19	Komuna e Suharekës	34
Komuna e Kaçanikut	20	Komuna e Vitisë	35
Komuna e Kastriotit	21	Komuna e Vushtrrisë	36
Komuna e Klinës	23	Thirjet tjera	36
Komuna e Lipjanit	23		

# HYRJE

Zgjedhjet parlamentare në nëntor të vitit 2007 u bënë me lista të hapura. Kjo u dha mundësi qytetarëve të votojnë më parë për individë e jo si parti politike. Ky sistem i ri u mundësoi qytetarëve të monitorojnë dhe të kërkojnë llogari prej politikanëve për premtimet e dhëna gjatë fushatës parazgjedhore. Megjithatë, politikanët vazhdojnë më shumë t'u japin llogari vendim-marrësve ndërkombëtarë se sa qytetarëve që ua dhanë votën. Qytetarët kanë nevojë për informata, mekanizma, dhe përkrahje për të monitoruar punën e politikanëve dhe kërkojnë prej tyre të adresojnë politikat e strategjitë që janë më prioritare.

Për ta ndihmuar këtë proces, nga marsi i vitit 2008, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) përkrahur nga Ambasada Britaneze në Kosovë dhe nga Posta dhe Telekomit i Kosovës (PTK), ka inicuar projektin Zëri i Votuesve. Ky projekt ka për qëllim që t'u jap mundësi qytetarëve të Kosovës të shprehin shqetësimet e tyre dhe t'i njoftojnë udhëheqësit e zgjedhur me prioritetet e tyre nëpërmjet tre mekanizmave: Linjës Telefonike Zëri i Votuesve, linjë kjo pa pagesë dhe anonime (0800 201 401), e-mail adresës (zerivotuesve@gmail.com), si dhe nëpërmjet takimeve të organizuara në komuna. Qëllimi i këtij raporti është të paraqes prioritetet e ngritura nga votuesit gjatë periudhës gjashtë mujore nëpërmjet këtij projekti për të përcjell punën e politikanëve të zgjedhur se sa po i realizojnë premtimet e dhëna. Raporti përfshin rekomandimet për politikanët e zgjedhur bazuar në kërkesat prioritare të qytetarëve.

# METODOLOGJIA


Përfundimet e prezantuara sa vijon janë të bazuara në 1052 thirrjet telefonike të qytetarëve, 44 emailave dhe shqetësimeve të shprehura gjatë takimeve në tetë komuna: Gjakovë, Vushtrri, Kastriot, Viti, Drenas, Mitrovicë dhe Fushë Kosovë. Të gjitha thirrjet e bëra në linjën e Zëri i Votuesve janë regjistruar në bazën e të dhënave Microsoft Excel. Thirrjet më pas janë koduar në bazë të çështjes që kanë ngritur qytetarët. Baza e të dhënave pastaj është pastruar dhe të dhënat janë renditur sipas frekuencës së thirrjes lidhur një çështjeje të caktuar. Gjithashtu, emailat janë regjistruar në bazën e të dhënave Microsoft Excel e cila pastaj është koduar dhe renditur sipas llojit të shqetësimit dhe/apo sugjerimit të paraqitur. Gjithashtu është bërë transkripti i takimeve të mbajtura në tetë komuna dhe janë regjistruar çështjet e ngritura nga qytetarët që ishin pjesëmarrës. Përfundimet janë organizuar në këtë raport i cili përfshin përgjithësimin e të gjitha thirrjeve të bëra në linjën Zëri i Votuesve, top dhjetëshen e çështjeve të ngritura nga qytetarët si dhe një prezantim të prioriteteve të qytetarëve nga komunat të renditura në mënyrë alfabetike.

# ANKESAT E KUJT JANË NË KËTË RAPORT?

Nga data 16 shtator 2008 dhe 16 mars 2009, janë bërë 1052 thirrje në linjën telefonike Zëri i Votuesve. Prej tyre 277 janë bërë nga femra dhe 775 nga meshkuj. Qytetarët kanë thirrur prej 28 komunave, 35 sa ka gjithsejtë Kosova. Për 61 thirrje nuk është bërë i ditur vendi i thirrjes. Tabela 1 paraqet numrin e thirrjeve të bëra nga secila komunë. Më së shumti thirrje janë bërë nga Prishtina (164). Tetëdhjetë e dy nga Prizreni, 74 nga Gjakova, 73 nga Drenasi, 52 nga Malisheva, 50 nga Peja, 45 nga Skenderaji, 42 nga Suhareka, 41 nga Podujeva, 39 nga Ferizaj, 39 nga Klina, 38 nga Mitrovica, 37 nga Rahoveci, 28 nga Gjilani, 27 nga Dragashi, 23 nga Vushtrri, 22 nga Deçani, respektivisht Lipjani, 19 nga Kastrioti, 17 nga Istogu dhe Vitia. Dhjetë apo më pak persona kanë thirr nga Fushë Kosova, Kaçaniku, Shtime, Dardanë, Hani i Elezit, Artana dhe nga Shtërpce.




## Komunat sipas numrit të thirrjeve



# TOP DHJETËSHI I SHQETËSIMEVE TË QYTETARËVE

Ankesat më të shpeshta të bëra nga qytetarët kishin të bënin më reduktimet e rrymës (116 thirrje), rrugët e pashtuara (92), korrupsioni (74), papunësia (69), nepotizmi (44), reduktimet e ujit (40), varfëria (38), kanalizime jo adekuate (25), shërbime të dobëta shëndetësore (24) dhe ndotja e ambientit (17).



Kryeministri vazhdimisht thirret në zbatimin e ligjit ndërsa lejon personat që kanë bërë keqpërdorime financiare, (si p.sh. ish Kryetari i Kuvendit të Kosovës ndaj të cilit është ngritur padia penale për keqpërdorim në vendin e punës), të shëtisin lirisht rrugëve sikurse s'kanë bërë asgjë. Si juriste, e di që në rast se ndaj një personi ngritet padi penale, ai person duhet të arrestohet me qëllim që gjyqi të konstatoj të vërtetën.

Ankesa tjera të paraqitura nga një numër i qytetarëve përfshijnë: statusi ende i pazgjedhur i Mitrovicës; shërbime të dobëta për pensionistët; mos kujdes ndaj familjeve të veteranëve të luftës; dhuna në shkolla; asistencë e ulët sociale; shpenzime të larta për transport; si dhe shërbime jocilësore shëndetësore. "Sistemi shëndetësorë nuk funksionon siç do të duhej, sepse shërbyesit civil, mjekët, janë duke përfituruar në biznes", qytetari vazhdon:

E di nga përvoja personale se menaxhmenti i Klinikës Neurologjike dërgon pacientët nga spitali publik në klinikat e tyre private për të bërë inqizimet CT. Një veturë private që i përket Euromed-it pret gjithnjë pranë Klinikës Neurologjik për të dërguar pacientët në klinikën e tyre private, ku qytetarët Paguajnë 200 euro, përderisa shërbimet shëndetësore në spital kushtojnë vetëm 35 euro dhe funksionon siç duhet. Për më tepër, Drejtori i Spitalit Neurologjik ka klinikë private që bën inqizimet CT. Mjekët nga kjo klinikë i dërgojnë pacientët në klinikën e tij private në vend se të ofrojnë shërbime shëndetësore të volitshme për qytetarët, siç do të duhej të ishte duke u bazuar në përgjegjësitë e tyre.

Qytetarët gjithashtu kanë bërë thirrje dhe kanë shkruar për të thënë se janë kundër kërkesës së Kuvendit të Kosovës për ngritje të shpenzimeve për nevoja të deputetëve si dhe kundër gjashtë pikave të Ban Ki Moon-it të propozuara për Kosovën. Gjithashtu qytetarët kanë kërkuar adaptimin e ligjit mbi Pasurinë dhe Prejardhjen e Pasurisë, në mënyrë që votuesit të monitorojnë ndërrimin e pasurisë së politikanëve pas zgjedhjes.

# ZËRI I VOTUESVE NË KOMUNA

Nëpërmjet linjës telefonike, emailit dhe takimeve në tetë komuna, qytetarët raportuan çështje në 28 komuna përgjatë tërë Kosovës. Më poshtë në renditje alfabetike sipas komunës janë të paraqitura shqetësimet që kanë ngritur qytetarët. Secili seksion del me rekomandimet që duhet ndërmarr nga autoritetet e komunës në mënyrë që t'i kënaqin votuesit e tyre.

## Komuna e Artanës

Tre qytetarë kanë thirrur nga komuna e Artanës për të shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me mungesën e ujësjellësve si dhe varfërinë që ka përfshirë këtë komunë. Në një prej thirrjeve një qytetar është shprehur si vijon: "Ujësjellësi në fshatin tonë nuk funksionon ende, edhe pse është premtuar se do të bëhet shumë shpejt nga kryetari i komunës gjatë fushatës së tij parazgjedhore".

Bazuar në thirrjet në Zërin e Votuesve, autoritetet e kësaj komune duhet të ndërtojnë një sistem ujësjellësi funksional si dhe të punojnë në krijimin e politikave që do të mund të ndikojnë në zhvillimin ekonomik në këtë komunë.

# Komuna e Dardanës

Nga komuna e Dardanës kemi pranuar pesë thirrje të cilat përfshijnë shumë ankesa të qytetarëve: mungesën e rrugëve të asfaltuara apo asfaltim i dobët i rrugëve, shërbime jo cilësore shëndetësore, mungesa e ujit, papunësia, reduktimet e rrymës si dhe korrupsioni. Një qytetar është shprehur: "Rruga për Koliqke nuk është asfaltuar edhe pse kjo është premtuar gjatë fushatës zgjedhore nga qeveria e tanishme". Autoritetet në Dardanë duhet të sigurohen që premtimet e tyre të dhëna gjatë fushatës të përmbushen duke e bërë asfaltimin e rrugëve. Ata gjithashtu duhet të gjejnë mënyra për të përmirësuar cilësinë e shërbimit shëndetësor, të ofrojnë zgjidhje për ndërprerjet e shpeshta të ujit dhe të rrymës, të adresojnë korrupsionin si dhe të promovojnë politika që çojnë kah zhvillimi ekonomik në këtë regjion.

# Komuna e Deçanit

Nga Komuna e Deçanit janë pranuar gjithsejtë 22 thirrje. Shumica e thirrësve ishin të shqetësuar për rrugët e pashtuara, sidomos atë që lidh Deçanin me fshatrat si Glogjan dhe Ballaboq. Qytetarët gjithashtu shprehin pakënaqësinë e tyre për reduktimet e rrymës; reduktimet e ujit; papunësisë; dhunës në shkolla si p.sh. "Hivzi Sylejmani" në fshatin Dobrajë e Madhe si dhe në shkollën "Migjeni" në fshatin Glogjan; tarifa të shtrenjta për trafikun urban; asistencë sociale e pamjaftueshme; korrupsion në ndarjen e shërbimeve sociale; shërbime jo cilësore shëndetësore; dëmtimi i pyjeve sidomos në bjeshkët e Strellcit si dhe paga të ulëta për punëtorët e arsimit. Për shembull, një qytetare si pasojë e rrugëve të pa ndërtuara dhe shpenzimeve për të udhëtuar e ka ndërprerë shkollimin. Ajo është shprehur kështu:

Jam nga fshati Baballoq, shkolla e mesme është shumë larg nga fshati im dhe shpenzimet rrugore janë të papërbalueshme për mua, prandaj më është dashur të ndërpres shkollimin. Bëj apel te qeveria të bëjnë rrugën për shkolla pa pagesë sepse nuk jam unë i vetmi rast që e kam ndërprerë mësimin për këtë arsye, ka edhe shumë raste tjera.

Sa i përket edukimit, në bazë të Nenit 47 mbi Ligjin për Edukim, Qeveria e Kosovës duhet të siguroj transport pa pagesë për nxënës. Përmirësimi i qasjes në arsimim mund të ndikoj gjithashtu edhe në përmirësimin e gjendjes ekonomike për qytetarët e kësaj komune. Autoritetet në Deçan, sipas kërkesave të qytetarëve duhet gjithashtu të zhvillojnë rrugët; të gjejnë zgjidhje për reduktimet e rrymës dhe të ujit; të adresojë dhunën në shkolla; të ulen çmimet e trafikut urban; të përmirësoj kualitetin e asistencave sociale; të ofrojë shërbime më të mira shëndetësore; të adresojë çështjen e dëmtimit të pyjeve; për shembull duke i përforcuar dënimet; si dhe të përkrahë iniciativat për të ngritur pagat e punëtorëve në sektorin e arsimit.

# Komuna e Dragashit

Qytetarët e Dragashit me njëzet e shtatë thirrjet e pranuar nga kjo komunë, kanë shprehur pakënaqësitë e tyre të shfaqura nga mos efikasiteti i pushtetit lokal në këtë komunë. Pakënaqësitë më të theksuara kishin të bëjnë me mungesën e rrugëve të asfaltuara; mungesë e ngrohjeve në shkolla; korrupsion në gjykatën e qarkut; nepotizmi; mungesa e shkollave; ndotja e ambientit; reduktimet e rrymës si dhe shërbime jo cilësore shëndetësore. Ja se si është shprehur një qytetar për korrupsionin që po ndodh në komunën e Dragashit:

Në fabrikën e tekstit drejtori është i korruptuar. Për të hyrë në punë, ai kërkon 30 euro dhe pas 3 muajve ai të largon nga puna. Unë kam bërë edhe incizime në momentin që më ka kërkua 200 euro. I kam dërguar në polici, por nuk është ndërmarr asgjë, as nga prokuroria, as nga policia e as nga kryetari i komunës edhe pse të gjithë i kam informuar.

Kryetari i komunës Salim Jonuzi ka anuluar projektin për zgjerim të shkollës edhe pse ka qenë projekt qysh nga pushteti i kaluar dhe janë ndarë mjetet për këtë projekt, por me ardhjen e tij në pushtet është anuluar. Kryetari i gjykatës merr hapa të padrejtë dhe vendime në gjykata. Ka korrupsion në komunën e Dragashit si në spital, në gjykata, në komunë apo polici.

Votuesit që kanë telefonuar kanë kërkuar vëmendje nga autoritetet e Dragashit që të bëjnë asfaltimin e rrugëve, të ofrojnë ngrohje në shkolla; të adresojnë korrupsionin dhe nepotizmin; të sigurojnë qasje në arsimim; të adresojnë problemin e ndotjes së ambientit dhe të reduktimeve të rrymës; si dhe të përmirësojnë shërbimet shëndetësore.

# Komuna e Drenasit

Nga komuna e Drenasit janë pranuar gjithsejtë shtatëdhjetë e tri thirrje nga qytetarët prej të cilave ankesat kryesore dalin të jenë: papunësia; mungesa e rrugëve të asfaltuara; mungesa e kanalizimeve; reduktimet e rrymës; varfëria si dhe mungesa e stacioneve për ndalje të trenit në fshatin Dobroshevc prej nga lidhen gjashtë fshatra të Drenasit e që u mundëson qytetarëve të kësaj komune udhëtim në linjën Pejë- Prishtinë.

Ankesa tjera nga kjo komunë janë: moskujdes për familjet e dëshmorëve; moskujdes për invalidët e luftës; kushte të këqija për invalidë; mos ndërtimi i shtëpive të dëmtuara gjatë luftës; ndotja e ambientit. Një qytetar thotë: "Tani posa i përcolla fëmijët për në shkollë, rruga nëpër të cilën ata kalojnë është e përfshirë nga ujërat e zeza edhe pse është premtuar se do të rregullohet."

Gjatë takimit të Zërit të Votuesve me qytetarët e Drenasit të mbajtur në Drenas më 9 tetor 2008, qytetarët plotësuan ankesat në vijim: ndotja e ambientit nga Fabrika e Feronikelit. Ata kërkuan informata të detajizuara nga qeveria për ndikimin që ndotjet e Feronikelit kanë në shëndetin e banorëve të Drenasit. Qytetarët gjithashtu ngritën zërin në lidhje me mbeturinat në rrugët e qytetit; djegja e mbeturinave nga qytetarët; ndërtime pa leje; papunësia; emërtimi i vendbanimeve me emra serb; mungesë e shenjave të trafikut që po i rrezikojnë jetërat e fëmijëve; dështimi në rindërtimin e shtëpive të rrënuara gjatë luftës; mungesa e sheshit të qytetit; pasiguria në shkolla si dhe mungesa e shkollave gjë që i detyron nxënësit të ndjekin mësimin në distanca të largëta.

Familjarët e personave të pa gjetur kërkuan nga autoritetet të marrin masa në zbardhjen dhe identifikimin e fatit të 173 personave që ende janë të zhdukur që nga koha e



luftës si dhe të adresojnë nepotizmin që po ushtrohet nga autoritetet në ndarjen e asistencave sociale dhe pronave për familjet e veteranëve të luftës.

Ekonomia e pa zhvilluar e komunës ishte një brengë tjetër e qytetarëve duke përfshirë këtu pagesat e ulëta, shqetësimet e tyre mbi rrezikun e mos mbjelljes së zonave bujqësore për shkak të çmimeve shumë të shtrenjta të naftës, farës dhe plehërosjes.

Në fillim të takimit, kryetari i komunës pranoi se autoritetet nuk kanë pyetur sa duhet qytetarët për prioritetet e tyre. Edhe pse u tha kështu, kryetari i komunës si dhe zyrtarët e tjerë komunalë e lëshuan takimin menjëherë, duke thënë se qytetarët do të ndiheshin më të lirë të shprehin pakënaqësitë nëse nuk ka zyrtarë në sallë. Tani pasi që qytetarët e Drenasit kanë shprehur pakënaqësitë e tyre të cilat janë regjistruar, autoritetet e Drenasit duhet të veprojnë për të adresuar shqetësimet e qytetarëve.

Autoritetet e kësaj komune duhet t'i japin prioritet politikave që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik në këtë regjion, të ndërtojnë rrugët, të bëjnë instalimin e ujësjellësve, të gjejnë zgjidhje për reduktimet e rrymës, të përmirësojnë transportin hekurudhor, të adresojnë çështjen e ndotjes së ambientit, të ndalojnë ndërtimet pa leje, të ndërrojnë emrat e vendbanimeve, të vendosin shenjat e trafikut, të ndërtojnë sheshin e qytetit, të rrisin sigurinë në shkollë, ta bëjnë shkollimin të mundshëm për qytetarët, si dhe të përkrahin politikat që përmirësojnë zhvillimin e bujqësisë. Ata duhet gjithashtu të punojnë në çështjen e personave të zhdukur, moskujdesin për familjet e veteranëve të luftës dhe personave me aftësi të kufizuara; si dhe në ndërtimin e objekteve të rrënuara gjatë luftës.

# Komuna e Ferizajit

Nga tridhjetë e nëntë thirrje të pranuar nga kjo komunë, shqetësimet më të mëdha kishin të bëjnë me: mungesën e rrugëve të asfaltuara; reduktimet e rrymës; papunësia; shqetësime rreth Planit Gjashtë Pikësh të Ban Ki Moon-it; korrupsioni nga gjyqtarët, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe korrupsioni qeveritar; asistenca të dobëta për rastet sociale dhe nepotizmi. Ja si shprehet një qytetar për problemin e papunësisë: "Papunësia veç po rritet, ata (politikanët) vetë gënjejnë se kanë për të ofruar punë, por në fakt ata vetëm po i nxejnë karriget e veta dhe nuk po lodhen për qytetarët e shkretë". Në Ferizaj, zyrtarët e zgjedhur duhet të gjejnë mënyra për të adresuar shqetësimet e qytetarëve për asfaltimin e rrugëve, të gjejnë zgjidhje për reduktimet e rrymës, të përkrahin politikat që ndikojnë në shtimin e mundësisë për t'u punësuar, të adresojnë korrupsionin në qeveri, të përmirësojnë asistencat sociale dhe të adresojnë nepotizmin.

# Komuna e Fushë Kosovës

Nga kjo komunë kemi pranuar dhjetë thirrje ku qytetarët shprehën pakënaqësitë e shkaktuara nga: reduktimet e shpeshta të rrymës si p.sh në fshatin Grabovc, mungesa e rrugëve të asfaltuara; reduktimet e ujit; ndërtimet pa leje; nepotizmi dhe papunësia. Qytetarët shprehën: “Nuk kemi ujë gjatë tërë ditës, vetëm 1 orë në ditë, as rrymë, ndodhë që nga dy ditë nuk kemi”.

Shqetësimet dhe ankesat e përcjella nga qytetarët e komunës së Fushë Kosovës fillojnë me banorët e lagjes së Mirenajve të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të familjeve të 16 dëshmorëve të luftës.

Ankesa kryesore e banorëve të lagjes Mirena ishte rruga e pa rregulluar nga e cila sipas tyre rrezikohen fëmijët e tyre gjatë udhëtimit për në shkollë. Ndër të tjera gratë e lagjes Mirena shprehën “ose të shtrohet rruga në të cilën kalojnë fëmijët tanë për të vijuar mësimin ose ne 12 nënat e veja me 37 fëmijë do të dal m në rrugë der sa kjo të rregullohet”. Ankesë tjetër e banorëve të kësaj lagjeje ishte edhe papunësia e lartë që i kanos këto familje në të cilat jetojnë 12 gra të veja me 37 fëmijë, gjë që sipas tyre lidhet me nepotizmin në punësim dhe neglizhencën e këtyre familjeve nga autoritetet komunale. Gjithashtu shprehën edhe shqetësimin e tyre lidhur me mungesën e ndriçimit të rrugës, kanalizimet e hapura që rrisin rrezikun që iu kanoset fëmijëve të tyre gjatë vijimit të shkollës sidomos për ata fëmijë që përfundojnë orarin mësimor në ora 19:00 pasdite. Shqetësim tjetër ishte edhe largimi i ambulancës shëndetësore nga qendra e qytetit dhe dërgimi i saj në Bresje gjë që sipas tyre kjo u vështirëson atyre qasjen në shëndetësi. Për të adresuar shqetësimet e votuesve të tyre, autoritetet komunale duhet të ofrojnë rrymë, rrugë, ujë, të kenë më shumë kujdes për ndërtimet pa leje dhe nepotizmin, si dhe të përkrahin politika që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.

# Komuna e Gjakovës

Qytetarët e Gjakovës bënë shtatëdhjetë e katër thirrje, gjatë të cilave parashtruan këto ankesa: mungesa e rrugëve të asfaltuara sidomos ato që lidhin fshatrat si Vathaj, Shapater, Gramaqel, Hereq, Partaj, dhe Dobrosh; reduktimet e rrymës në fshatin Dobrosh; mungesa e ujit dhe e ujës-jellës siç ndodh në fshatin Demjan; varfëria; asistencë e ulët për rastet sociale; vonesë në pajisje me dokumente, ndotja e ambientit. Një qytetar thotë kështu: "Thaçi duhet të mendon dhe të brengoset për varfërinë që po mbizotëron fshatrat. Kur po vie puna për votime ata (politikanët) po japin premtime dhe po thonë se do të përmirësojnë shumë gjëra, e në fakt nuk po bëjnë asgjë. Rrugët na janë premtuar e asgjë deri më tani nuk ka ndodhur".

Gjatë takimit të mbajtur në Gjakovë më 18 shtator 2008 qytetarët shprehën shqetësimet për: gjendjen e rëndë ekonomike në komunë; për Veriun e Mitrovicës ku ata shprehën se janë jashtë kontrollit të institucioneve të Kosovës; mos angazhimi i duhur në njohjen e shtetit të Kosovës nga shtetet në botë; mërgimi në rritje i të rinjëve të Gjakovës; mungesa e zhvillimit të bujqësisë; problemet me ujës-jellës në fshatrat e komunës; ndërtime të egra në qytet; gropat në rrugët e qytetit; vështirësitë e pensionistëve për shkak të pagesës së ulët të pensionit përkundër problemeve të tyre shëndetësore; problemet me shëndetësi sidomos në zonat rurale ku është mungesë e qendrave ambulatore; shqetësimet në lidhje me parkun e Gjakovës për të cilin u tha se ekziston rreziku të merret për ndërtimin e një kisha; dhe mungesën e shkollave në disa fshatra të Gjakovës me ç'rast fëmijët duhet të vijnë në mësimin në fshatra tjera pavarësisht nga fakti se këto

shkolla mund të jenë në largësi deri në 4-5 kilometra.

Ndër qytetarët pjesëmarrës, të pranishëm ishin edhe nxënës të shkollave të mesme të cilët parashtruan ankesat e tyre lidhur me mungesën e sigurisë në shkolla, ushtrimin e dhunës fizike dhe psikike (kërcënime) të nxënësve nga ana e mësimitdhënësve, mungesën e pajisjeve nëpër shkolla. Pjesëmarrësit nga Hasi i Gjakovës ngritën shqetësime lidhur me kushtet e vështira të jetesës, mungesën e shkollave të mjaftueshme dhe kushtet minimale në shkolla.

Në komunën e Gjakovës, pushtetarët e zgjedhur duhet të kenë prioritet: asfaltimin e rrugëve; të sigurojnë rrymë dhe ujë; t'u ofrojnë fshatrave qasje në ujë të pijshëm; të bëjnë politika që do të ndikonin në uljen e varfërisë; të rrisin punësimin; të përkrahin bujqësinë; të përmirësojnë asistencat sociale përfshirë këtu pensionistët; të përmirësojnë procedurat për dhënien e dokumenteve zyrtare; të krijojnë një plan të mirëfilltë urbanistik duke u konsultuar me qytetarët; të sigurojnë qasje në shërbime shëndetësore; të ruajnë parkun e Gjakovës; dhe të sigurojnë edukim pa dhunë në shkolla.

# Komuna e Gjilanit

Nga komuna e Gjilanit janë pranuar njëzet e tetë thirrje. Një numër i qytetarëve janë ankuar për nepotizëm në gjykata, duke drejtuar ankesat për korrupsion tek dy gjykatës: Shefqet Xhelili dhe Mursel Ahmeti. Ata gjithashtu paraqitën nepotizmin në shkolla, tek udhëheqësit komunalë si dhe ne Kombinatin e Duhanit. Një qytetare shprehet: “Jam e pakënaqur me punën e Kuvendit Komunal të Gjilanit, nepotizmi i ka përfshirë të gjitha sektoret, si për punë, si për shkollë, nëse nuk ke të njoftshëm nuk mund të bësh asgjë”. Qytetarët gjithashtu shprehën shqetësim sa i përket varfërisë; papunësisë; mos zhvillimit ekonomik; si dhe paaftësia e qeverisë të kundërshtoj planin gjashtë pikësh të Ban Ki Moon. Qytetarët e Gjilanit kërkuan nga qeveria që të kenë prioritet adresimin e nepotizmit, varfërisë, papunësisë, korrupsionit; dhe zhvillimin ekonomik.

# Komuna e Hanit të Elezit

Katër thirrje janë bërë nga kjo komunë, ku qytetarët paraqitën ankesat e tyre për nepotizmin, papastërtinë në shkolla (në veçanti shkollën Dardania); dhe korrupsioni në Drejtoratin për Shëndetësi pranë Komunës së Hanit të Elezit. Qytetarët gjithashtu e kritikuan qeverinë për mospagimin e 20 përqindëshit për ish punëtorët e Fabrikës së Çimentos pas privatizimit të kësaj fabrike. Një qytetar tha:

Kam ankesa për Bahri Shabanin sa i përket privatizimit, nuk po e paguajnë 20% e borxheve që i kanë ndaj punëtorëve. Privatizimi nuk ka patur sukses as sa ka qenë Ahmet Shala e as tash. Bahri Shabani ka dosje në gjyq që janë bërë padi kundër tij për shkak të korrupsionit. Gjithashtu mua më intereson pse nuk është bërë asgjë sa i përket djegies së dokumenteve të privatizimit. Mua po më intereson nëse Hashim Thaqi është i njoftuar për të gjitha këto, pse bëhet i shurdhër mos është edhe vet i përfshirë në korrupsion. Përse gjyqi nuk po ndërmerr asgjë kundër këtyre njerëzve të korruptuar, por ata po vijjnë në pozita udhëheqëse.

Në këtë komunë të re të Hanit të Elezit zyrtarët komunal duhet të gjejnë mënyra për të ndaluar korrupsionin në procesin e privatizimit, të adresojnë nepotizmin dhe të përmirësojnë gjendjen mësimore në shkolla.

# Komuna e Istogut

Në linjën telefonike kanë thirrur shtatëmbëdhjetë qytetarë nga komuna e Istogut. Ankesat më të shpeshta ishin për reduktimet e rrymës sidomos në fshatrat si Surrogoll dhe Siligan; reduktimet e ujit, rrugët e pa asfaltuara; varfëria; mungesa e kontrollit ushqimor; kushtet e rënda për jetesë, si dhe mos ekzistimi i ligjit për invalidët e luftës. Një qytetar nga fshati Suhagrellë tha:

Komuna nuk po interesohet të vijë dhe ta rregulloj trafon e rrymës. Rrugën e kemi katastrofë ajo rrugë lidh shumë komuna, na lidh edhe me Mitrovicën, ujin e kemi larg 3 km, nuk kemi ujësjellës që ta bartim nga atje e as komuna nuk po interesohet për këtë.

Për qytetarët e Istogut, autoritetet duhet të fokusohen në daljen nga kriza ekonomike, në mungesën e rrymës elektrike, ujë, rrugë, strategji për parandalim të varfërisë, të përmirësojnë kontrollin për produktet ushqimore si dhe të gjejnë mënyra për të përmirësuar kushtet e jetesës.



# Komuna e Kaçanikut

Nëntë thirrje janë pranuar nga Komuna e Kaçanikut. Ankesat më të shpështa kishin të bëjë më korrupsionin qeveritar, sidomos nga kryetari i komunës, nepotizmi në gjykata, kërkesa për të paguar RTK-në në faturat e rrymës edhe pse qytetarët nuk kanë qasje në RTK për shkak të mos mbulimit të rrjetit; shkalla e lartë e varfërisë si dhe mos asfaltimi i rrugëve. Një qytetar tha:

Kam problem me Gjykatën Komunale në Kaçanik, gjykatësi Hebib Livoreka, po e vonon landën duke e shëtitur në Gjykata, unë e kam fituar të drejtën për pasuri pasi që burri me ka vdekë, por ai po e vonon landën që unë të mos mundem të barti pasurinë sepse ai (gjykatësi) po e favorizon kunatin pasi që e ka vendas. Kjo landë është prej vitit 2001.

Për qytetarët e Kaçanikut, më e rëndësishmja është që qeveria të adresoj korrupsionin qeveritar dhe nepotizmin. Politikanët e zgjedhur gjithashtu duhet të avokojnë për largimin e taksave për RTK-në pasi që ata nuk kanë qasje në këtë televizion publik, të promovojnë politika që qojnë në zhvillim ekonomik si dhe të bëjnë ndërtimin e rrugëve.

# Komuna e Kastriotit

Qytetarët e komunës së Kastriotit bënë 19 thirrje në linjën Zëri i Votuesve ku ata shprehën pakënaqësitë e tyre për reduktimet e shpeshta elektrike sidomos në fshatin Raskovë; ndotja e ambientit; mungesa e ndërtimit të shtëpive të rrënuara gjatë luftës; mungesa e pajisjeve të nevojshme në shkolla, si dhe kushte të rënda të shërbimeve shëndetësore. Një qytetarë shpreh brengën e tij për ndotjen e ambientit në komunën e Kastriotit:

Në komunën tonë ka shumë pluhur nga termocentrali, kryetari po lejon të ndërtohet edhe termocentrali C, e për këtë punë duhet të bëhet diçka, e jo të hel mohemi ne. Ne si shqiptar e paguajmë rrymën, e serbët jo, e as kjo nuk është në rregull. Në Plemetin nuk dihet a është luftë, apo çfarë po ngjet, çdo dite gjua një me armë serbët e nuk vjen askush të kontrolloj. I kanë lejet e regjistrimit fals me targa Beogradi ose Novi Pazar e askush si ndalon. Policia nuk ndërmerr asgjë për të ndaluar këtë.”

Gjatë takimit me qytetarë të mbajtur më 22 Shtator 2008 në komunën e Kastrioti, pjesëmarrësit gjithashtu u ankuan për pluhurin që po krijohet çdo ditë, si pasojë e termocentraleve. Ata gjithashtu shprehën pakënaqësi për infrastrukturën e kësaj komune, duke shtuar se nuk ka plan afat gjatë urbanistik apo nuk ekziston fare një I plan i tillë.

Bashkëpunimi joadekuat në mes të Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës dhe Kuvendit Komunal ka rezultuar në atë që KEK-u ka dështuar të paguaj taksat pa marrë

parasysh obligimet ligjore, kanë thënë qytetarët e kësaj komune. Ata ishin të shqetësuar për reduktimet e rrymës që po ndodhin në vazhdimësi, duke theksuar se qytetarët e Kastriotit jetojnë pranë dy termocentraleve dhe për këtë arsye atyre së paku duhet të ju sigurohet rryma. Qytetarë tjerë thanë se shtëpitë e tyre janë ende të rrënuara nga vërshimet e ujit, gjë e cila paraqet rrezik për shëndetin e tyre, e për këtë zyrtarët komunal nuk po ndërmarrin asgjë.

Tutje, nxënësit e kësaj komune u ankuan për mos pranim adekuat arsimor si pasojë e mungesës së shkollave. Menaxhimi i dobët nga Drejtori i Drejtoratit për Edukim në Komunën e Kastriotit ka dërguar deri tek ajo që fëmijët të vazhdojnë mësimin në kontejner. Qytetarët gjithashtu shprehëm pakënaqësi për rrugët me gropa; mungesa e aktiviteteve për të rinjtë; si dhe papunësia që po ndikon në migrimin e të rinjve nga kjo komunë

Në përgjithësi, qytetarët e Kastriotit thanë se udhëheqësit e tyre të zgjedhur si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror kanë harruar premtimet që u kanë bërë votuesve. Politikanët e zgjedhur duhet të marrin aksion për të adresuar problemin e reduktimeve të rrymës, ndotjes së ambientit, shtëpive të rrënuara, nevojën për qasje në shkollim dhe shkollim kualitativ, gropat në rrugë dhe përmirësimin e gjendjes në shëndetësi. Ata duhet gjithashtu të kenë një plan urbanistik i cili do të duhej të bëhej në bashkëpunim me qytetarët.

## Komuna e Klinës

Qytetarët e komunës së Klinës nëpërmjet 39 thirrjeve të bëra në linjën telefonike paraqitën këto ankesa: mungesa e objekteve shkollore në fshatra si p.sh në fshatin Zabërgjë; rrugët e paasfaltuara si p.sh në Sferkë; papunësia; mungesa e ujësjellësve; mungesa e trafove dhe shtyllave elektrike; nepotizmi; dhe ndotja e ambientit. "Nuk kemi shkolla, na është premtuar se do të ndërtohet shkolla dhe me 1 Shtator do të fillojmë me shkollën e re por kjo nuk ka ndodh, kemi mungesë të ujit të pijshëm, dhe rruge të asfaltuara" thotë një qytetar. Prioritetet e qytetarëve janë që të kenë qasje në rrymë të përhershme, më shumë objekte shkollore, rrugë të asfaltuara; politika që do të shtojnë mundësitë për punësim; sistemin e ujësjellësit më të mirë; si dhe përmirësim të gjendjes së ambientit.

## Komuna e Lipjanit

Njëzet e dy thirrje janë pranuar nga komuna e Lipjanit. Qytetarët raportuan korrupsionin që po ndodh nga zyrtarët publik. Më specifikisht një qytetar ka pohoi se kryetari i komunës së Lipjani, Shukri Buja ishte i involvuar në korrupsion në shumë nivele:

Kryetari i Komunës së Lipjanit i ka shitur dy veturat pronë e komunës që kanë mbetur nga qeveria e kaluar. I ka shitur këto vetura dhe e ka blerë një të re të cilën poashtu prap e ka shitur për të blerë tjetrën, veturat po blihen e pastaj po ndërrohen në tregje pa asnjë përgjegjësi. Ngrohja qendrore në vend se të rregullohet ajo është shitur dhe tani nuk ekziston, vlera e një kazani është 75 mije euro, ne total mund të shkojë deri 300 mije. Kryetari i Komunës Shukri Buja e vënë në emër të kushëririt të tij këtë shitje. Bankën e kanë shënduar në

restorant të cilin e mban një mik i tij, por e gjithë kjo është vetëm mbulesë sepse në fakt kryetari i merr të ardhurat. Vëllezërit e tij tashmë janë bërë pronar të bufesë së ambulancës. Për rrugën Kraishte - Halla, ua ka dhënë tenderin një kompanie në vlerë prej 50 mijë euro, e ky ka qenë më i shtrenjti, ka mundur ta bëjë tërë këtë me më pak shpenzime, por kështu ka përfitimeve personale. Ai nuk e përfillë as gjykatën e Kosovës. Ai gjithashtu të gjithë kryetarët e fshatrave i ka bërë vetëm ata që janë të PDK-së pa i pyetur banorët.”

Qytetarët tjerë thirrën apo shkruan për të raportuar së kryetari ka blerë hapësirat publike në emër të dikujt tjetër duke e keqpërdorur kështu pozitën e tij.

Jam një qytetare nga Lipjani. Dua të ju shkruaj dhe të ju tregoj për 'dallaveret' që bëhen në komunën time. Kryetari i komunës posa ka marrë postin, ka marrë mbi vete në shfrytëzim tregun e lopëve dhe tregun e pemëve. Po ashtu edhe ndërtesën e Bankës për Biznes (pronë e Komunës) tani po e shndërron në restorant të vetin...

Qytetarët gjithashtu akuzuan Drejtorin e Drejtoratit për edukim Hajri Ramadanin për nepotizëm. Ankesa tjera të ngritura nga qytetarët përfshijnë ndërprerjet e rrymës elektrike në fshatrat si Sllovi; mos furnizim me ujë si dhe mungesa e ujësjellësve, papunësia, pagat e ulëta si dhe mos zbatimi I detyrës siç duhet nga ana e policisë. Votuesit kërkuan nga autoritetet të bëjnë adresimin e korrupsionit që po ndodh në mesin e udhëheqësve, sa me shpjegat që është e mundur. Ata gjithashtu kërkuan rrymë të përhershme, përmirësim të gjendjes së ujit dhe ujësjellësve; si dhe politika që krijojnë kushte punësimit dhe ngritje të pagave.

## Komuna e Malishevës

Qytetarët e komunës së Malishevës bënë pesëdhjetë e dy thirrje. Ankesat më të shpeshta të bëra nga qytetarët kishin të bënin me korrupsionin dhe nepotizmin sidomos në sistemin arsimor. Ministri i Arsimit dhe Kryetari i Komunës së Malishevës nuk po punojnë siç duhet për të parandaluar nepotizmin që po shfaqet në shkollat e Malishevës, tha një votues. Ai shtoi se persona të pakualifikuar po merren në punë si mësues në shkolla sepse të afërm të këtyre personave janë në fuqi. Qytetarët shprehën ankesa edhe për rrugët e pa asfaltuara; reduktimet e rrymës; reduktimet e ujit siç ndodh në fshatin Drenovc të kësaj komune; plani gjashtë pikësh i Ban Ki Moon-it si dhe asistenca të ulëta sociale. Rryma dhe punësimi janë premtuar nga PDK-ja se do të rregullohen, gjithashtu është premtuar edhe shërbime shëndetësore më të mira, por asgjë nuk është rregulluar.” Autoritetet duhet të koncentrohen në adresimin e korrupsionit, nepotizmit, reduktimeve të rrymës, reduktimeve të ujit si dhe rrugët e pa asfaltuara.

## Komuna e Mitrovicës

Tridhjetë e tetë thirrje janë bërë nga komuna e Mitrovicës. Shqetësimet kryesore për këtë komunë janë shprehur edhe gjatë takimit me qytetarët të mbajtur me 10 Tetor 2008, e këto shqetësime ishin: statusi i pazgjedhur i Mitrovicës dhe dështimi në ofrimin e strehimit për qytetarët shqiptar të zhvendosur nga shtëpitë e tyre prej veriut të qytetit “ Qeveria e Kosovës nuk po bënë asgjë për veriun e Mitrovicës” tha një qytetar, “sidomos për ne qytetarët që na u është dashur të lëshojmë shtëpitë tona, na kanë mbetur shtëpitë e të gjitha atje e ne nuk po kemi as me çfarë të jetojmë”. Qytetarët duan të dinë arsyet se përse autoritetet nacionale dhe komunale nuk kanë ndërmarr asgjë për shitjen e shtëpive dhe pasurive që po bëjnë shqiptarët e veriut të Mitrovicës. Ata kërkuan nga qeveria të krijojë strategji që do të ndihmonin qytetarët shqiptar në veri të Mitrovicës, në mënyrë që ata të mos lëshojnë shtëpitë e tyre. Tutje, ata fajësuan institucionet ndërkombëtare dhe lokale për privilegjin që po u bëjnë minoritetit serbë duke u lejuar atyre të shkelin ligjin e duke mos u kërkuar prej tyre të

paraqiten në drejtësi për veprat e tyre. Ata gjithashtu shprehën pakënaqësinë e tyre ndaj autoriteteve të cilat nuk e kanë përfillur kërkesën e shumicës së qytetarëve për largim të administratës së UNMIK-ut nga Mitrovica.

Gjatë takimit në Mitrovicë, përfaqësuesit e Organizatës Handikos, kërkuan nga autoritetet komunale të plotësojnë nevojat e tyre, përfshirë këtu përmirësimin e kushteve jetësore, qendrat reabilituese, më shumë mundësi punësimi si dhe trajtim i duhur nga autoritetet qeverisëse.

Një tjetër prioritet i votuesve nga Mitrovica ishte dënimi i zyrtarëve publik të cilët janë të përfshirë në korrupsion. Telefonuesit kanë akuzuar për korrupsion kryetarin e komunës së Mitrovicës, Ministrin e Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala, si dhe Drejtorin e Urbanizimit të Mitrovicës Mehdi Bala. Telefonuesit gjithashtu shprehën se korrupsioni që gjendet në radhët e inspektorëve komunalë ka mundësuar ndërtimin pa leje që po rrezikon jetën e qytetarëve. Kualiteti i ulët i edukimit ishte një tjetër shqetësim i qytetarëve. Ata thanë se si pasojë e infrastrukturës shkollore jo adekuate, mësuesit dhe arsimtarët duhet të mbajnë nga dy orë në të njëjtën hapësirë dhe në të njëjtin vend. Ata gjithashtu janë të detyruar të mbajnë mësim me orar të shkurtuar, më vetëm 35 minuta kohëzgjatje. Kur tërë kësaj të i shtohet edhe numri i madh i nxënësve, deri 50 nxënës në një klasë, do të thotë që nxënësit nuk po marrin edukim kualitativ. Qytetarët gjithashtu e cekën mungesën e shkollave në gjuhën shqipe në veri të Mitrovicës, numrin e kufizuar të studentëve që pranohen në universitetin publik si dhe mos licencimi i universiteteve private. Qytetarët shtuan edhe shqetësimin e tyre për nepotizëm, papunësia, reduktimet e rrymës, reduktimet e ujit; rrugët e pa asfaltuara; mos trajtim i duhur i pensionistëve dhe invalidëve të luftës; si dhe punë jo e mirë e anëtarëve të kuvendit.

Votuesit nga Mitrovica u bënë thirrje autoriteteve komunale dhe nacionale të mundësojnë kthimin e banorëve shqiptarë në shtëpitë e tyre në veri; të krijojnë politika drejt shtimit të mundësive për punësim; të sigurohen që edhe qytetarët serb të respektojnë ligjin; të ndërtojnë më shumë shkolla e sidomos nëpër zonat rurale; të shtojnë numrin e studentëve që pranohen në universitetin publik; të adresojnë më mirë nevojat e personave me aftësi të kufizuara; të ndalojnë ndërtimet pa leje, si dhe të hulumtojnë rastet e dyshimta për korrupsion në mesin e zyrtarëve publik.

# Komuna e Pejës

Qytetarët e komunës së Pejës bënë 50 thirrje për të shprehur shqetësimet për: varfërinë; korrupsionin; kushte të rënda jetese për personat me aftësi të kufizuara; rrugët e paasfaltuara përfshirë këtu rrugën në lagjen Kapeshnicë; moskujdes për banorët e zonave rurale; mungesa e sigurisë për qytetarët; statusi ende i pazgjedhur i Mitrovicës; si dhe ndotja e ambientit. Një qytetarë shprehet: “Papunësia në nivel të lartë, rrugët e pa ndrequra, rrymë me reduktime, katastrofë në të gjitha anët”. Për të adresuar shqetësimet e qytetarëve të Pejës, autoritetet duhet të përkrahin politika drejt uljes së varfërisë, të adresojnë korrupsionin, të gjejnë mënyra për të përmirësuar kushtet e jetesës për personat me aftësi të kufizuara, të ndërtojnë rrugët, të adresohen nevojat e qytetarëve në zonat rurale, të përmirësojnë sigurinë, të përkrahin negociatat për zgjidhjen e statusit të Mitrovicës si dhe të adresojnë ndotjen e ambientit.



# Komuna e Podujevës

Katërdhjetë e një thirrje kanë bërë qytetarët e Podujevës për të ngritur zërin e tyre ndaj korrupsionit qeveritar, rrugëve të pa asfaltuara; papunësisë, reduktimeve të rrymës, shërbime të dobëta për pensionistët, si dhe asistencë sociale të pamjaftueshme. "Ankesa ime i drejtohet kryetarit të komunës i cili ka asfaltuar vetëm 30 metra rrugë, në lagjen Ilir Ponushevc", thotë një qytetar. "Ai pastaj e ka ndërprerë asfaltimin e rrugës sepse aty jetojnë tetë familje që nuk i përkasin partisë së tij politike". Në Podujevë, zyrtarët e zgjedhur mund të adresojnë shqetësimet e qytetarëve duke e adresuar korrupsionin që ndodh në qeveri, të ndërtojnë rrugët, të zhvillojnë politika që përkrahin zhvillimin ekonomik, të përmirësojnë shpërndarjen e rrymës elektrike, të punojnë në sigurimin e pensioneve më të mira për pensionistët, dhe të ofrojnë asistencë sociale më adekuate.

# Komuna e Prishtinës

Thirrjet më të shumta në linjën telefonike Zëri i Votuesve janë bërë nga komuna e Prishtinës. Njëqind e gjashtëdhjetë e katër thirrje janë bërë nga kjo komunë prej të cilave: për të shprehur shqetësimin e tyre për papunësinë (26), dështimi në zgjidhjen e statusit të ish punëtorëve të Shtëpisë së Mallrave Gërmia (15); reduktimet e rrymës (12); korrupsioni, siç është me rastin e dhënies së tenderëve për asfaltimin e rrugëve si dhe korrupsioni i ujësjellësit "Ibër-Lepenci" (13); varfëria (12); asistenca të ulëta sociale (10); nepotizmi (9), rrugët e pa asfaltuara, sidomos në periferi të Prishtinës siç është rasti në lagjen Kodra e Trimave dhe në Lagjen e Spitalit (8); reduktimet e ujit (7); pagat e ulëta (5); shërbime të dobëta për pensionist (5); vonimi në dhënie të dokumenteve identifikuese (5); ndërtimet pa leje (4); si dhe mos efikasiteti i qeverisë në parandalimin e dhunës në familje (4). Për shembull, një qytetar thotë:

Qeveria ka premtuar shumë e nuk kanë bërë asgjë, rrymë e të gjitha janë premtuar e asgjë nuk po përmirësohet. As punë as asgjë, ata (politikanët) po punojnë vetëm për interesa të veta, punësojnë vetëm familjarët e tyre. Ata nuk kanë kapacitet të na udheheqin shtetin, janë treguar të pa aftë. Jemi plotësisht të pakënaqur. Edhe policia janë të korrumpuar, joprofesional. Policia janë duke e rrezikuar Kosovën, qeveria janë vetëm duke na e rrezikuar jetën.

Më specifikisht, qytetarët akuzuan Ekrem Rexhën, Ridvan Shahinin, Rafki Sadiku dhe Dhurata Ramadanin për korrupsion. Autorët e këtij raporti nuk kanë hulumtuar akuzat e bëra nga qytetarët prandaj kërkojnë nga policia dhe sistemi i drejtësisë të hulumtojnë këto deklarime.

Në Prishtinë, politikanët që kërkojnë të rizgjidhen duhet të veprojnë në bazë të kërkesave që votuesit e tyre i kanë shprehur, përfshirë këtu krijimin e politikave që do të ndikonin në zhvillim ekonomik, të zgjedhin statusin e punëtorëve të Shtëpisë së Mallrave Gërmia, të rregullojnë furnizimin më rrymë dhe me ujë, të adresojnë korrupsionin, nepotizmin, si dhe ndërtime pa leje; të ndërtojnë rrugët; të punojnë në krijimin e një plani më të mirë për asistencë sociale, përfshirë këtu pensionet; të mundësojnë marrjen e dokumenteve zyrtare në një periudhë me të shpejtë; si dhe të përkrahin politikat që kontribuojnë në uljen e dhunës në familje.

# Komuna e Prizrenit

Tetëdhjetë e dy qytetarë kanë thirrur nga Komuna e Prizrenit për të shprehur pakënaqësitë në lidhje me ndërprerjet e rrymës në fshatrat si Srebrenicë e Poshtme, si dhe në lagjen Jelenicë ne Prizren (13 thirrje); rrugët e pa asfaltuara si p.sh rruga Dervish Hima (7); papunësia (5); reduktimet e ujit (5); vonesa në dhënien e dokumenteve (5): shërbime të dobëta për veteranët e luftës (3); shërbime të dobëta për personat me aftësi të kufizuara (3); dhuna në shkolla (4); si dhe dështimi në zgjidhjen e statusit të Mitrovicës (3). Një qytetar shprehet : "Nuk po zgjidhet asnjë problem e sidomos sa i përket Mitrovicës, qeveritarët janë aty vetëm kot, nuk bëjnë asgjë që duhet, nuk ka punësim, nuk ka asgjë".

Gjatë takimit me qytetarë më 7 Tetor 2008, votuesit gjithashtu kërkuan nga liderët e zgjedhur të i japin fund punësimit me baza partiake. Ata kërkuan nga zyrtarët publik të furnizojnë shkollat siç duhet; të ofrojnë infrastrukturë më të mirë në hapësirat publike për personat me aftësi të kufizuara; të krijojnë strategji që ndikojnë në zhvillimin ekonomik; të jenë më transparentë si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror, të bëjnë renovimin e konviktit të studentëve; të adresojnë reduktimet e rrymës, të rregulojnë ujësjellësit; të vendosim më shumë shtylla ndriçuese nëpër rrugë; të sigurojnë pjesëmarrje më të lartë të grave brenda komunës; të intervenojnë të ndalin kompanitë që po e dëmtojnë Drinin e Bardhë; të sigurojnë shërbime më të mira shëndetësore. Në fshatra, banorët shprehën brengën e tyre për mungesë të stafit profesional mjekësor. Prandaj, në mënyrë të vazhdueshme ata duhet të shkojnë në vende tjera, gjë që i vë në rrezik.

# Komuna e Rahovecit

Nga tridhjetë e shtatë thirrje të bëra nga komuna e Rahovecit, shumë qytetarë janë ankuar për reduktimet e rrymës sidmos në fshatin Krajk ku qytetarët thanë se nuk kishin rrymë për 11 muaj. Votuesit shprehën shqetësimet e tyre për reduktimet e ujit; rrugët e pa asfaltuara; kushtë të rënda për fermerë dhe bujqësi; ngacmimi seksual ndaj kandidatëve për punë femra; mungesa e transparencës nga qeveritarët gjatë shpenzimit të bugjetit; dështimi në ofrimin e ndihmës për familjarët e veteranëve; dhe asistenca të ulëta sociale. Në lidhje me ngecjen në zhvillimin e bujqësisë qytetarët shprehën: “Qmimet bujqësore janë shumë të ulëta në treg, ndërsa për t'u kujdesur për bimë po bëhet shumë shtrenjtë. Institucionet tona e kane lënë anash bujqësinë”. Për të patur politika që do të ndihmonin në shpejtimin e zhvillimit bujqësorë, politikanët e zgjedhur dihet të gjejnë mënyra për të patur rrymë dhe ujë të vazhdueshëm; të ndërtojnë rrugët; të ndërtojnë rrugët; të krijojnë dhe të zbatojnë ligje kundër ngacmimit seksual ndaj kandidatëve për punë; të shtojnë transparencën sa i përket bugjetit; dhe të ofrojnë asistencë më të mira sociale përfshirë këtu edhe për familjarët e veteranëve të luftës.

## Komuna e Shtërpçës

Dy thirrje janë bërë nga komuna e Shtërpçës për të shprehur pakënaqësitë e tyre për mos efikasitetin e Ministrisë së Kthimit, shërbimeve të dobëta shëndetësore dhe gjendjen e rëndë ekonomike. Një qytetar është shprehur: "Ministria e Shëndetësisë ka mbetur shumë mbrapa, ministri duhet të largohet nga ushtrimi i detyrës sepse asgjë nuk ka përmirësuar deri me tani". Politikanët e zgjedhur duhet të adresojnë shqetësimet e votuesve të tyre duke siguruar efikasitet nga Ministria e Kthimit, të përmirësojnë shërbimet shëndetësore si dhe të zhvillojnë strategji që ndihmojnë zhvillimin ekonomik.

## Komuna e Shtimes

Shtatë qytetarë nga kjo komunë kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me varfërinë; moskujdesi për familjet e veteranëve të luftës; mos llogaritja e stazhit të bërë gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë si dhe mos zgjedhja e statusit të Mitrovicës. Ja si e përshkruan situatën në komunën e Shtimes një qytetar: "Varfëri e madhe, nuk po kemi as bukë të u japim fëmijëve, sidomos tani në këto kohë të vështira. Nuk po mundem më, po kam frikë se do të vdesim nga varfëria".

Autoritetet komunale duhet të krijojnë strategji që përkrahin zhvillimin ekonomik në këtë rajon, të bëjnë presion tek autoritetet nacionale që të sigurojnë realizimin e pensioneve të premtuara nga ish-Jugosllavia, si dhe të inkurajojnë përfaqësuesit nacional të zgjidhin statusin e Mitrovicës.

## Komuna e Skenderajt

Qytetarët e Komunës së Skenderajt bënë katërdhjetë e pesë thirrje për të shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me: varfërinë; reduktimet e rrymës sidomos në fshatin Kuqice; nepotizmin; reduktimet e ujit dhe mungesa e ujësjellësve; rrugët e paasfaltuara në fshatrat si Lecine dhe Surigon; asistencë e ulët sociale si dhe shërbime të dobëta shëndetësore. Një qytetarë shpreh: "Papunësia është shumë e madhe, në punë futen vetëm ata që kanë të njohshëm". Për të adresuar shqetësimet e votuesve, autoritetet duhet të krijojnë politika që e ulin varfërinë, i rrisin mundësitë për punësim; të zhvillojnë resurse tjera energjetikes dhe rregullojnë furnizimin me ujë. Ata gjithashtu duhet të bëjnë asfaltimin e rrugëve, të shtojnë asistencat sociale dhe ofrojnë shërbime më të mira shëndetësore.

## Komuna e Suharekës

Gjithsejtë janë bërë katërdhjetë e dy thirrje nga qytetarët e komunës së Suharekës, që kishin të bënin më: reduktimet e rrymës; reduktimet e ujit; sisteme jo adekuate ujësjellësi; rrugët e pa asfaltuara; papunësia; korrupsioni; dështimi në ndërtimin e shtëpive të rrënuara gjatë luftës; shërbime të dobëta shëndetësore si dhe shërbime të pamjaftueshme sociale. Një qytetar i komunës së Suharekës e përshkruan kështu gjendjen e familjes së tij: "I kemi shtëpitë e djegura, po jetojmë në shtëpi të huaja, nuk na ndihmon askush. Ne nuk kemi as ku të drejtohem, kemi qenë disa herë në komunë të kërkojmë ndihmë mirëpo askush nuk po interesohet."

Bazuar në thirrjet në linjën telefonike Zëri i Votuesve, autoritetet komunale duhet të fokusohen në përmirësimin e elektricitetit dhe furnizimin me ujë; të instalojnë sisteme ujësjellësi adekuate; të ndërtojnë rrugët; të krijojnë politika që ndikojnë në zhvillimin ekonomik; të adresojnë korrupsionin; të ndërtojnë shtëpitë e rrënuara nga lufta; të ofrojnë shërbime shëndetësore kualitative dhe të përmirësojnë shërbimet sociale.

# Komuna e Vitisë

Shtatëmbëdhjetë thirrje janë bërë nga qytetarët e komunës së Vitisë, telefonuesit kanë akuzuar zyrtarët publik për korrupsion përfshirë këtu edhe kryetarin e komunës së Vitisë, si dhe Nexhmedin Arifin, Xhevat Bislimin, Skender Habibin, gjykatësin Ibrahim Idrizi si dhe zyrtarët tjerë të përfshirë procesin e privatizimit. Qytetarët gjithashtu u ankuan për ndërtimet pa leje; nepotizëm; dështimin për të ndihmuar familjarët e veteranëve të luftës; largimi nga puna për shkak të mos përkatësisë partiake. Një qytetarë thotë: "Në komunën tonë ka shumë ndërtime pa leje, mosfunksionim i gjyqësisë, shtëpitë ndërtohen në oborret shkollore, trotuarët përdoren për ndërtime të ndryshme sidomos prej kafeterive".

Gjatë takimit më 25 Shtator 2008, qytetarët e Vitisë gjithashtu diskutuan për korrupsionin që ndodh brenda komunës së tyre. Ata kërkuan që të formohet një komision specifik i cili do të gjente burimet e pasurisë së politikanëve si dhe të sigurojnë që bizneset të paguajnë taksat e tyre. Qytetarët deklaruan se largimet nga puna në sektorin arsimor po bëhen kryesisht nga mos përkatësia e njëjtë partiake dhe kërkuan që kjo dukuri të zhduket. Më specifikisht, nxënësit e shkollës së mesme "Kuvendi i Lezhës" paraqitën pakënaqësinë e tyre për politizimin e shkollave.

Qytetarët që morën pjesë në takim paraqitën brengat e tyre në lidhje me dështimin e qeverisë për të zbatuar Ligjin mbi Barazi Gjinore; uljen e papunësisë; gjë që ka shtyrë të rinjtë e Vitisë të migrojnë; si dhe çmimet e larta jetësore duke pasur parasysh gjendjen aktuale ekonomike, që do të thotë se qytetarë me vështirësi i mbulojnë shpenzimet e nevojshme elementare.

Votuesit u bënë thirrje autoriteteve komunale të adresojnë korrupsionin në komunë, si dhe ndërtimet pa leje, nepotizmin, dhe largimin nga puna për shkaqe partiake. Politikanët e zgjedhur duhet të përkrahin politika drejt përmirësimit të kujdesit për familjet e veteranëve të luftës si dhe të punojnë drejt zhvillimit ekonomik.



# Komuna e Vushtrrisë

Qytetarët bënë njëzet e tri thirrje dhe morën pjesë në takimin e mbajtur në Komunën e Vushtrrisë në datën 19 Shtator 2008, gjatë të cilit takim qytetarët shprehën shqetësimet në lidhje me reduktimet e rrymës në qytet dhe në fshatra siç është rasti i fshatit Lumi i Madh; lobim i pamjaftueshëm nga ana e Ministrit Për Marrëdhënie me Jashtë i cili nuk po bën sa duhet në njohjen e Kosovës; varfërinë dhe papunësinë; rrugët e pa asfaltuara; mos furnizimin me ujë, në disa vende kanë qasje në ujë vetëm 15 minuta deri në dy orë me ujë në ditë; mospagimi i 20 përqindëshit pas procesit të privatizimit ; shërbime të dobëta shëndetësore dhe mangësitë në sistemin arsimor. Një qytetar thotë: “Nuk kemi pasur rrymë për dy ditë radhazi, e ata nuk kanë bërë asgjë për këtë”.

Politikanët e zgjedhur duhet të kërkojnë zgjidhje për energjetikë, të promovojnë politika që ndikojnë në zhvillim ekonomik, të bëjnë asfaltimin e rrugëve, të përmirësojnë furnizimin me ujë, të sigurohen që kontratat e privatizimit po respektohen, të përmirësojnë gjendjen në arsim si dhe të përmirësojnë shërbimet shëndetësore.

## Thirrjet tjera

Linja telefonike Zëri i Votuesve ka pranuar 61 telefonata nga qytetarë të cilët nuk e kanë bërë të ditur vendi e thirrjes. Në këto telefonata qytetarët kanë shprehur ankesat e tyre për paga të ulëta, papunësinë; reduktimet e rrymës si dhe propozimin e Kuvendi të Kosovës për rritje të pagave të deputetëve, shpenzimet e karburanteve dhe shpenzimet tjera.

